

KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET PËR TU PAJISUR ME AUTORIZIM NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR

Shërbimi i transportit ndërkombëtar rrugor në linjë të rregullt të udhëtarëve.

Për të ushtruar veprimtarinë në shërbimin e transportit ndërkombëtar rrugor në linjë të rregullt të udhëtarëve, pas pajisjes me licencë për transport ndërkombëtar rrugor, subjekti aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për transportin për tu pajisur me autorizim për operimin në një linjë të rregullt të caktuar dhe/ ose në transportin e rregullt të specializuar. Të drejtën për tu pajisur me autorizim e fitojnë vetëm subjektet me eksperiencë në transportin rrugor brenda vendit ose në transportin rrugor ndërkombëtar në shërbime të rastit, jo më pak se 3 (tre) vjet, e cila provohet nga eksperiencia e vetë subjektit ose e drejtuesit të veprimtarisë.

Autorizim për të operuar në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus.

Autorizimi lëshohet për linja të rregullta ndërkombëtare të miratuara nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese, bazuar në marrëveshjet dypalëshe për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve. Miratimi i linjës nënkupton miratimin e itinerarit sipas një rendi udhëtimit me pika nisëse, pika kufitare hyrëse/ dalëse, vendqëndrime (stacione) dhe pika mbërritëse të paracaktuara.

Subjekti i bashkëngjtit kërkesës, sipas *Lidhjes 5*, dokumentet si më poshtë:

- llojin e veprimtarisë që kërkohet të kryhet,
- të dhëna për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën,
- adresën e plotë të zyrës/ selisë/ filialit për ushtrimin e veprimtarisë,
- regjistrimi në QKB ose Ekstrakti i QKB, ku në objektin e veprimtarisë të përcaktohet aktiviteti transport ndërkombëtar rrugor i udhëtarëve me autobus,
- dokumenti që vërteton se subjekti zotëron, të paktën një mjet të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, (targën/ targat e mjetit/ mjeteve që do përdoren) të regjistruara në QKB, shoqëruar me NUIS dytësor, (certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm),
- plotësimi i kriterit të reputacionit të mirë për subjektin (përfaqësuesin ligjor dhe/ ose pronarin/ pronarët), si dhe për drejtuesin e veprimtarisë, që provohet me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit,
- dokument që vërteton zotërimin e CKP, për personin që drejton veprimtarinë e transportit që do të licencohet,
- kontrata e punës, akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës lidhur ndërmjet përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe drejtuesit të veprimtarisë, në rastet kur subjekti nuk plotëson kërkesën e kompetencës profesionale,
- dokument i qëndrueshmërisë financiare.

Subjekti i bashkëngjtit aplikimit për autorizim sipas *Lidhjes 6*, dokumentet si më poshtë

- a) plan biznesi të detajuar ekonomik-financiar për vitet në vijim, (informacion në lidhje me vëllimin e shërbimit që aplikanti planifikon të kryejë);
- b) një kopje e njëzuar e licencës së lëshuar nga QKB për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve;
- c) licencën e agjencisë për transport ndërkombëtar të udhëtarëve, lëshuar nga bashkia ku fillon linja, apo regjistrimin me NUIS dytësor të aktivitetit të agjencisë. Nëse nuk disponon licencë, paraqet kontratën me një agjenci të licencuar;
- d) dokumentat provues dhe shoqërues që vërtetojnë se subjekti ka në pronësi ose me qiramarrje, me afat jo më pak se një vit, numrin e nevojshëm të mjeteve për transport ndërkombëtar të udhëtarëve që plotësojnë standardet teknike të kërkuara. Për çdo mjet të marrë me qira, krahas dokumentave provues (shkonja k), më poshtë), aplikuesi paraqet NUIS dytësor;

- e) kontratën e partneritetit, ose kontratën me një agjenci të licencuar në shtetin tjetër, ose licencën për shërbimin agjenci sipas legjislacionit në fuqi të shtetit tjetër, në rastet kur kërkohet sipas marrëveshjeve dypalëshe, (në katër kopje, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën e shtetit palë në marrëveshje, ose në gjuhën angleze, ku tekstet në të dy/ tre gjuhët të jenë autentike);
- f) rendin e udhëtimit me distancat kilometrike për çdo segment rrugor sipas itinerarit të linjës, ditët e operimit (frekuencën ditore, javore) me oraret e nisjes dhe të mbërritjes, bazuar në kontratën e partneritetit;
- g) tabelën e kohës së drejtimit të mjetit për të lejuar verifikimin e pajtueshmërisë me legjislacionin në lidhje me kohën e punës dhe periudhën e pushimit;
- h) projekt-tarifat e biletave të udhëtimit dhe bagazheve, të shoqëruar me elementet e kostos së tarifës të propozuar, të cilat miratohen nga autoriteti kompetent;
- i) hartën sipas itinerarit të linjës përkatëse, me një shkallë të përshtatshme ku të dallohen qartë pika e nisjes (vendi origjinës), vendkalimet kufitare, vendqëndrimet dhe pika e mbërritjes (vendi i destinacionit);
- j) dokumentin vërtetues të njehsuar me origjinalin për objektin e shërbimit të parkingut (në pronësi ose me qira) të mjeteve, vetëm për rastet kur parashikohet në marrëveshjet dypalëshe;
- k) listën e autobusëve që do përdoren në linjën/njat e kërkuar/a. Autobusët që do paraqiten për aplikim, duhet të jenë të pajisur me:
 - akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit, të autobusëve në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve sipas aneksit nr. 2, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.08.1999, të ndryshuar;
 - policë sigurimi se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, të ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:
 - i. sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;
 - ii. sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.
 - certifikata e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm;
 - certifikata e kalibrimit të tahogرافit;
- l) certifikatat e aftësisë profesionale (CAP), për çdo drejtues mjeti.
 - Për rinovim të autorizimit subjekti paraqet dokumentet, sipas shkronjave b), c), d), e), f), g), h), i), j), k), l) dhe informacion mbi volumin e transportit të udhëtarëve deri në afatin e përfundimit të autorizimit të mëparshëm, si dhe dokumentin vërtetues nga zyra përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore.
 - Për rastet e modifikimit të linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve me autobus, (zgjatimit të linjave, ndryshimit të vendqëndrimeve, të ditëve apo orarit të operimit), lëshohet një autorizim tjetër, me të njëjtin numër rendor me fraksion, por me të njëjtën periudhë vlefshmërie, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 10.1, për rinovimin e autorizimit.

Çdo autobus që kryhen një shërbim, i cili është subjekt autorizimi, duhet të ketë në bordin e tij një autorizim origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin/ të certifikuar nga autoriteti që e ka lëshuar.

Numri i autobusëve në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta përcaktohet nga sektori/ zyra/ specialisti përgjegjës, në bazë të frekuencës së udhëtimeve, distancës së udhëtimit duke u siguruar që subjekti të ketë mjete të mjaftueshme për vazhdimin e shërbimit pa ndërprerje.

Shënim: Të gjithë dokumentat e kërkuara sipas udhëzimit nr. 8, datë 19.12.2019, që gjenerohen on-line, nuk paraqiten nga subjekti, por sigurohen nga zyra, specialisti përgjegjës.